

Komuna e Suharekës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Suharekës udhëhiqet nga kryetari Blerim Kuçi i cili vjen nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Kuçi e ka ushtruar mandatin e parë në këtë pozitë (2009-2013) dhe nuk do të rikandidoj për një mandat shtesë.
2. Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Suhareka ka 59.722 banorë.¹ Për nga numri i banorëve, kjo komunë është e përafërt me Komunën e Drenasit, Lipjanit dhe Rahovecit.
3. Komuna e Suharekës, njëjtë si Komuna e Gllogovcit, Istogut, Novobërdës, Podujevës, Obiliqit, zyrtarisht mban tjetër emër, kurse me tjetër emërtim i referohet praktikisht. Kësisoj, dokumentacioni lëshohet me emërtimin Suharekë, ndërsa në përditshmëri përdoret emërtimi Therandë.
4. Komuna e Suharekës ka gjithsej nëntë drejtori. Për dallim nga komunat e tjera, në Suharekë ekziston edhe Drejtoria për Mërgatën.
5. Struktura politike e përfaqësuar në Kuvendin Komunal përbëhet nga 11 këshilltarë të LDK-së, 10 të PDK-së, 10 të AAK-së, dy nga LDD, një nga AKR dhe një këshilltar nga Partia Socialiste e Kosovës.
6. Në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve nëpër komunat e vendit i realizuar nga UNDP i përmbledhur në raportin “Mozaiku i Kosovës 2012” rezulton se 69% e banorëve të Suharekës besojnë se autoritetet e tyre lokale janë kompetente për të zgjidhur problemet në komunën e tyre, kurse 17% besojnë se këto probleme mund të zgjidhen vetëm nga pushteti qendror.²

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 146. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

7. Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore të Komunës së Suharekës kanë qenë mungesa e ujit të pijes, prezenca e ujërave të zeza në disa vendbanime, komunikacioni i dendur, degradimi i tokës bujqësore si dhe mungesa e hapësirave të gjelbëruara.³

Problemet kryesore të Komunës së Suharekës 2013

1. **Mungesa e ujësjellësit dhe ujit të pijes.** Problem për fshatrat e Suharekës është mungesa e ujësjellësit. Fshatarët janë të detyruar t'i përmbushin nevojat e tyre me hapjen e puseve, por që gjatë verës edhe ato shterohen dhe kështu ata përballesh me mungesë të ujit të pijshëm. Fshatrat Reqan, Bukosh dhe Peqan përballesh me këtë problem. Përveç mungesës së rrjetit të ujësjellësit në fshatra, Suhareka vazhdon të përballesh me reduktime të shpeshta të ujit të pijes në qytet. Kjo mungesë po ndikon edhe në institucione publike si në shkolla, qendra klinike të mjekësisë familjare si dhe në vetë objektin e komunës. Të dhënat nga hulumtimi i UNDP-së, tregojnë se furnizimi i ujit nga ujësjellësi publik është mjaft problematik në komunën e Suharekës. Vetëm 18% e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik (në krahasim me mesataren e Kosovës 42%) pohojnë se kanë furnizim të pakufizuar me ujë. Njëzet e gjashtë përqind kanë ndërprerje të furnizimit me ujë prej 1 deri në 4 orë në ditë, 7% kanë ndërprerje të furnizimit prej 5 deri në 10 orë në ditë, kurse për 32% ndërprerjet ditore të furnizimit me ujë zgjasin më shumë se 11 orë. Një numër prej 16% e familjeve të Suharekës të lidhura me ujësjellësin publik kanë thënë se ndërprerjet e ujit në vendbanimin e tyre zgjasin më shumë se tri orë gjatë çdo shkyçjeje Përqindja e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik të cilat raportojnë probleme me cilësinë e ujit të pijshëm është e ngjashme me mesataren e Kosovës. Shtatëmbëdhjetë përqind e tyre kanë thënë se uji i çezmës është i turbullt nga papastërtia, 35% se shtypja është shumë e ulët për shfrytëzim shtëpiak, 14% kanë deklaruar se ka shije të keqe, dhe 13% se ka erë të keqe.⁴
2. **Mungesa e ndriçimit publik.** Aktualisht vetëm rruga “Brigada 123” dhe rruga “Skënderbeu” që shkon për në fshatin Reshtan kanë sistem të ndriçimit publik. Ndërsa rrugët periferike në qytet

³ Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Suharekës. 2009. Fq 3. Burimi:

http://www.institutigap.org/documents/90907_Suhareka-raporti%20komunal.pdf

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 153.

Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

por edhe në fshatra janë pa ndriçim publik. Në disa vende ekzistojnë llambat elektrike por nuk funksionojnë. Lokalitetet tjera në rajonin e Suharekës janë pa ndriçim publik madje edhe në afërsi të institucioneve publike si në afërsi të shkollave dhe ambulantave. Në hulumtimin e USAID/DEMI, 58% e qytetarëve të kësaj ane nuk janë të kënaqur me ndriçimin publik.⁵

- 3. Gjendja jo e mirë e objekteve shkollore.** Në disa zona të Suharekës ndihet nevoja për riparimin apo edhe rindërtimin e objekteve shkollore. Kësisoj, në gjendje të keqe është shkolla fillore në fshatin Duhël dhe objekti i shkollës në fshatin Leshan i cili është i ndërtuar që nga viti 1946, ku në të zhvillojnë mësimin 480 nxënës. Edhe shkolla në fshatin Nishor është në gjendje jo të mirë. Në vitin 2010, MAPL kishte shpallur tender për ndërtimin e tri shkollave në këto tri fshatra, mirëpo tenderi ishte anuluar menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme të 2010. Probleme me infrastrukturën e shkollave janë hasur edhe në ato objekte ku ka pasur investime të konsiderueshme në riparimin e tyre. Në këtë gjendje është shkolla në fshatin Bllacë, ku pas një periudhe të shkurtër të përfundimit të punimeve në riparimin e shkollës, ka nisur lëshimi i ujit të shiut nga kulmi duke shtyrë udhëheqësit e shkollës të ndërpresin mësimin për disa ditë.
- 4. Prerja e pyjeve.** Dukuria e prerjes së pyjeve është e shprehur në masë të madhe në këtë komunë, e në veçanti në zonat e thella. Pyjet e fshatit Delloc dhe ato në Bjeshkën e Mushtitshtit gjithnjë e më tepër po shkatërrohen duke u prerë ilegalisht. Zyrtarët komunal janë shprehur disa herë që nuk kanë kapacitete të duhura për ta adresuar këtë problem, ngase mungojnë burimet njerëzore dhe ato teknike.
- 5. Ndotja e lumit “Toplluha”.** Lumi i qytetit “Toplluha” është problem që e ka përcjellë në vazhdimësi qytetin e Suharekës. Shumë fshatra përreth dhe zonat e qytetit bëjnë derdhjen e kanalizimeve në këtë lum duke ndotur shtratin e lumit dhe duke shkaktuar edhe kundërmime, veçmas gjatë zonës së verës.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Parku i qytetit.** Bashkëbiseduesit kanë shfaqur kërkesa që parku i rregulluar në qendër të qytetit duhet të mirëmbahet dhe duhet të zgjerohet edhe në pjesën e quajtur “Te Pishat”. Sipas bashkëbisedueseve, në atë pjesë (“Te Pishat”) nuk ka rrugë të

⁵ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 41. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

rregulluar, ulëse për qytetarët, shporta për hedhjen e mbeturinave si dhe mungon ndriçimi gjatë natës.

- 2. Ruajtja e tokës pjellore.** Duke marrë parasysh që Suhareka ka tokë pjellore, ruajtja e saj ka shumë përparësi. Por kohëve të fundit ato po shkatërrohen nga ndërtimet e zhvilluara. Gjithashtu, kjo po ndikon edhe në uljen e prodhimeve të rendimenteve nga ana e banorëve.


Trendet Buxhetore në Komunën e Suharekës

Komuna e Suharekës ka pasur një ngritje të vazhdueshme të buxhetit komunal gjatë katër viteve të fundit. Buxheti i komunës për vitin 2013 është 12.3 milion euro, ndërsa krahasuar me vitin 2010 ky buxhet ka shënuar ngritje prej 3.1 milion euro. Si pasojë e shpronësimit të pronave publike për shkak të ndërtimit të autostradës “Ibrahim Rugova”, në vitin 2012, Komuna ka shënuar një ngritje prej 2.3 milion euro në të hyrat vetanake. Në bazë të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP)⁶, me gjithë përmirësimin në inkasimin e të hyrave, Komuna e Suharekës duhet të përmirësojë planifikimin për tatimin në pronë. Po ashtu, ZAP ka gjetur se të hyrat e inkasuara nuk janë deponuar në bankë brenda afatit ligjor gjë që rritë mundësinë për keqpërdorim apo të humbjes së tyre. Në vitin 2013, komuna ka 14.6 mijë prona të regjistruara ndërsa në vitin 2012 një pjesë e madhe (80%) kanë kryer obligimet e tatimit në pronë.⁷

⁶ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Suharekës për vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 07 Gusht 2013, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KOB_2012_Shqip_671535.pdf http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KSU_2012_Shqip_752661.pdf

⁷ Komuna e Suharekës, Përgjigje në Kërkesën e Institutit GAP, 15 Gusht 2013


Figura 1. Buxheti i Komunës së Suharekës 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?suhareke/2013#/~/~suhareke>

Në bazë të grafikonit mbi trendet e ndarjeve buxhetore gjatë katër viteve të fundit shohim se pagat dhe mëditjet dhe shpenzimet kapitale kanë pasur një trend në ngritje me theks të veçantë në vitin 2011. Një e gjetur e ZAP-it për vitin 2012, tregon se ka pasur dobësi tek ekzekutimi i shpenzimeve kapitale pasi që vetëm 85% e tyre janë realizuar. Në vazhdim, lista e pagave është gjetur të mos jetë e azhurnuar në disa raste.

Figura 2. Trendet e Ndarjeve Buxhetore e 2010-2013



Krahasuar me vitin 2013, Komuna e Suharekës planifikon të ketë një rritje të buxhetit prej 3% në vitin 2014. Rritja e buxhetit vlerësohet të financohet kryesisht nga rritja e grantit qeveritar.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	12.594.078	12.685.929	12.951.463
Të hyrat vetanake	1.917.102	1.974.615	2.014.107
Grantet	10.676.976	10.711.314	10.937.356
Shpenzimet	12.594.078	12.685.929	12.951.463
Mallrat dhe Shërbimet	923.468	911.468	911.468
Pagat dhe Mëditjet	6.146.700	6.146.698	6.146.698
Shërbimet Komunale	293.000	293.000	293.000
Subvencionet dhe Transferet	282.000	262.000	262.000
Shpenzimet Kapitale	4.948.910	5.072.763	5.338.297

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe kampanjave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulamtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të respektueshme për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Suharekës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulamtiveve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012), etj.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.